



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Antropologji kulturore B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; (20 leksione + 20 seminare)

Viti / Semestri: Viti I, semestri II,

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim Ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh “

Kodi i etikës: Kodi i etikës UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs do të ndërgjegjësojë studentët mbi nevojën e interesimit për kulturat e tjera. Përtej kërkimesë fillestare, njohuritë e ofruara do t’u mundësojnë studentëve të kuptojnë që kultura jonë mëmë është një ndër të tjerat dhe jo kultura *par excellence*:

Objektivat specifike lëndore:

Në fund të këtij kursi studentët duhet të jenë të aftë të :

- të përftojnë njohuri mbi konceptin antropologjik të kulturës
- të kuptojnë, respektojnë dhe vlerësojnë diversitetin njerëzor, diversitetin kulturor
- të njohin rolin e kulturës në mendimin dhe sjelljen njerëzore dhe të identifikojnë etnocentrizmin
- të shqyrtojnë mënyrat e jetesës njerëzore në mënyrë holistike dhe krahasuese, duke aplikuar një perspektivë antropologjike në analizën e ngjarjeve aktuale dhe çështjeve shoqërore.
- të përcaktojnë dhe identifikojnë dimensionet të ndryshme të Kulturës: *modelet e jetesës, sistemet politike, familja, farefisnia, martesat, gjinia, raca, feja* etj.

Rezultatet e pritshme:

1. Njohja me konceptet dhe teoritë antropologjike – Studentët do të kuptojnë bazat e teorisë së mendimit antropologjik dhe do të jenë në gjendje të identifikojnë temat dhe qasjet kryesore të antropologjisë sociale dhe kulturore.
2. Zhvillimi i aftësisë për analizë ndërkulturore – Studentët do të jenë të aftë të analizojnë ngjashmëritë, ndryshimet dhe ndërveprimet mes kulturave të ndryshme duke përdorur qasje antropologjike.
3. Zgjerimi i perspektivës kritike dhe reflektuese – Studentët do të zhvillojnë një kuptim më të thelluar të diversitetit kulturor dhe do të reflektojnë mbi mënyrën se si njohuritë antropologjike ndikojnë në formësimin e qëndrimeve të tyre ndaj botës dhe të tjerëve.